— RAPORTI —

•I TRETË I• MONITORIMIT

PËR PUNËN E AVUKATURËS SË SHTETIT NË RMV

(për periudhën kohore: korrik-dhjetor 2019)

BE-ja për TY
SCOOP CIJ-MACEDONIA
Институт за човекови права
MEDIUM

RAPORTI

•I TRETË I•
MONITORIMIT

PËR PUNËN
E AVUKATURËS
SË SHTETIT
NË RMV

Raporti i tretë i monitorimit për punën e Avokaturës së Shtetit në RMV
(për periudhën kohore: korrik – dhjetor 2019)

Editor:
Instituti për të Drejtat e Njeriut

Redaktore:
Jelena Kadriq

Autore:
Vesna Stefanovska
Neda Petkovska

Përktheu:
Blerina Starova Zllatku

Dizajni grafik:
Relativ

Vendi dhe viti i botimit:
Shkup, dhjetor 2019

Ky publikim u hartua me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi ekskluzive e Institutit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja:

Hyrje.....5

Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Avokaturës së Shtetit në RMV.....6

Efektiviteti i punës së Avokaturave të Shtetit.....7

Monitorimi i procedurave gjyqësore në të cilat Avokatura e Shtetit e RMV paraqitet si përfaqësuese ligjore.....10

Ujdi jashtëgjyqësore për konteste me karakter pronësor-juridik.....10

Mbrojtja e të drejtave pronësore dhe interesave të RMV.....11

Denacionalizimi.....13

Ekspropriijimi i tokës.....14

Procedurat e athezionit.....14

Shuma e paguar/arkëtuar nga/në Buxheti i RMV në lidhje me procedurat gjyqësore.....15

Hyrje

Projektin "Bashkë në luftë kundër korrupsionit" e implementon SKUP, si bartës, dhe Instituti për të Drejtat e Njeriut (IDNJ) dhe Medium, si partnerë, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të sektorit qytetarë për realizimin e rolit monitorues të punës së autoriteteve shtetërore, me qëllim të ushtrimit të ligjshëm dhe transparent të funksionit, parandalimit të rreziqeve nga korrupsioni dhe parandalimit të shpërdorimit të detyrës zyrtare. Projekti është në vitin e dytë të implementimit.

IDNJ e monitoron punën e Avokaturës së Shtetit në RMV (ASHRMV) përmes monitorimit të procedurave gjyqësore dhe administrative në të cilat Avokatura e Shtetit paraqitet si palë në procedurë, përkatësisht si përfaqësuese ligjore të organeve shtetërore për të cilat është e autorizuar t'i përfaqësoj. Në përputhje me kornizën ligjore,[1] Avokatura e Shtetit është autoriteti i cili i mbron të drejtat pronësore dhe interesat e shtetit.

Duke i pasur parasysh raportet paraprak të monitorimit dhe faktin se puna e Avokaturës së Shtetit akoma nuk është e eksponuar në media, ndërkaq bëhet fjalë për punë kruciale, angazhimi i IDNJ përmes monitorimit të punës së ASHRMV ka për qëllim këtë institucion ta përafroj deri te qytetarët, por edhe t'i detektoj dobësitë gjatë punës, të cilat pastaj do të jenë bazë për përpilimin e propozim-masave për përmirësimin e punës së Avokaturës së Shtetit.

Raporti i tretë i monitorimit u hartua përmes grumbullimit të informacioneve, si vijon:

1. Pasqyra e të gjitha dokumenteve të publikuara në ueb-faqen e ASHRMV;
2. Paraqitja e kërkesave për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik;
3. Monitorimi i drejtpërdrejt i seancave gjyqësore në të cilat ASHRMV paraqitet si përfaqësuese sipas ligjit e RMV dhe të organeve shtetërore;
4. Monitorimi i informacioneve të publikuara në media të cilat janë relevante për punën e Avokaturës së Shtetit.

Objekt i analizës së Raportit të tretë të monitorimit është veprimi i Avokaturës së Shtetit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe interesave të RMV, me ç'rast theksi vendoset mbi procedurat gjyqësore në të cilat ASHRMV i mbron të drejtat pronësore të Republikës dhe/ose të organeve shtetërore. Pastaj, objekt i analizës ishin edhe procedurat e tjetërsimit të tokës ndërtimore në të cilat ky organ jep mendim/opinion (pozitiv/negativ) si dhe në procedurat e denacionalizimit dhe eksproprijimit.

1 Ligji për Avokaturën e Shtetit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 87/07, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2010). Funksionin e Avokaturës së Shtetit e ushtron Avokati i Shtetit i RMV dhe avokatët e shtetit për juridiksionin e gjykatave ku ushtrohet funksioni i Avokaturës së Shtetit.

Transparenca dhe llogaridhënia në punën e Avokaturës së Shtetit në RMV

Ueb faqja e Avokaturës së Shtetit,[2] e cila u përmirësua para disa muajsh, përmban të dhëna për strukturën organizative të organit, kornizën ligjore, raportet vjetore, planet strategjike dhe ngjashëm. Megjithatë, edhe më tutje mungon roli proaktiv i Avokaturës së Shtetit, përkatësisht mungesa e komunikimit me qytetarët si dhe nevoja e publikimit të mendimeve/opinioneve të cilat i jep ky organ për lidhjen e kontratave, përkatësisht për tjetërsimin e tokës ndërtimore si dhe për qiradhënie. Në mungesë të këtyre, por edhe të dokumenteve të tjera të rëndësishëm në (ueb-faqe) shumë vështirë mund të përafrohet puna e ASHRMV deri te qytetarët. Nëse e shohim Raportin vjetor për punën e ASHRMV për vitin 2018, mund të shihet se midis prioriteteve dhe qëllimeve strategjike theksohet mbrojtja juridike e të drejtave pronësore dhe interesave të RMV, dhe së këtejmi komunikimi midis ASHRMV dhe qytetarëve duhet të përmirësohet përmes prezantimit të punës së këtij organi publikut më të gjerë.

Në muajin nëntor krahas Raportit vjetor për vitin 2018 u publikuan edhe pasqyrat përmbledhëse për lëvizjen e lëndëve për vitin 2018 për juridiksionin e Shkupit si dhe për të gjitha juridiksionet e tjera nga të cilat mund të vërehet se sa lëndë janë në punë dhe nga të njëjtat sa janë zgjidhur dhe numri i lëndëve të cilat mbeten në punë.

<u>Komunikimi me publikun dhe komunikatat për publikun:</u>
Komunikatat për publikun kryesisht kanë të bëjnë me: njoftime për takimet e mbajtura, pjesëmarrje në ngjarje dhe takime të Avokatit të Shtetit me përfaqësuesit e institucioneve të RMV, me përfaqësuesit e korit diplomatik dhe ngjashëm. Në pjesën e ueb-faqes, e cila ka të bëjë me komunikimin me publikun mund të gjenden vetëm informacionet në lidhje me paraqitjen e kërkesës për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik; ligje dhe vendime; shpallje për punësim dhe ngjashëm.

Informacionet të cilat kanë rëndësi për punën rrjedhëse dhe të cilat do të ishin në interes të qytetarëve ose mediave nuk publikohen në formë të komunikatave. Kjo u apostrofua edhe në Raportin paraprak të monitorimit, dhe sipas kësaj situatë e njëjtë është detektuar përsëri. Akoma nuk organizohen pres-konferenca nga ana e Avokaturës së Shtetit në të cilat do të prezantohen segmente nga puna e këtij institucioni. Vërehet mungesë në aspektin e lëshimit të komunikatave për media, veçanërisht për lëndë të rëndësishme të cilat janë me interes për publikun, ndërkaq kanë të bëjnë me interesat pronësore të shtetit.

Sa u përket kërkesave për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik, duhet të theksohet se ASHRMV i përmbahet afatit ligjor deri në 30 ditë për përgjigje. Për nevojat e këtij Raporti të monitorimit, IDNJ pranoi përgjigje nga Avokaturat e Shtetit për juridiksionin e: Shkupit; Manastirit; Strugës; Gostivarit; Kumanovës; Tetovës; Ohrit; Shtipit; Velesit; Strumicës; Gjevgjelisë; Kërçovës; Prilepit; Koçanit dhe Kavadarit.

2 Ueb-faqja e ASHRMV: http://www.drzavnopravobranitelstvo.gov.mk/

Efektiviteti i punës së Avokaturave të Shtetit

Avokati i Shtetit dhe avokatët e shtetit i mbrojnë të drejtat pronësore dhe interesat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të organeve shtetërore të themeluara me ligj, para gjykatave dhe organeve të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Në përputhje me informacionet e pranuara nga Gjykata Themelore Civile - Shkup, për periudhën kohore nga data 1.5.2019 deri në datë 15.9.2019, janë evidentuar gjithsej 309 lëndë në të cilat si përfaqësues sipas ligjit paraqitet ASHRM, edhe atë:

Seksione	Akoma në punë	Gjithsej
Konteste pronësore, familjare dhe konteste me vlerë të vogël	36 lëndë	44 lëndë
Konteste tregtare, falimentimi dhe likuidimi[3]	10 lëndë	31 lëndë
Konteste pune	220 lëndë	231 lëndë
Jashtëkontestimore dhe trashëgimie	3 lëndë	3 lëndë

Problemet kryesore me të cilat akoma ballafaqohet Avokatura e Shtetit e RMV kanë të bëjnë me funksionimin e organeve nga aspekti i resurseve të reduktuara njerëzore. Me fjalë të tjera, në mbledhjen e mbajtur më 20 gusht të vitit 2019, Qeveria e miratoi Informatën[4] për nevojën e rritjes së numrit të avokatëve të shtetit në Avokaturën e Shtetit të RMV, por akoma nuk ka veprime konkrete në lidhje me këtë informatë. Pastaj, si pengesë theksohet procedura komplekse ligjore gjatë përpilimit dhe aprovimit të akteve juridike të ASH në procedura të caktuara në të cilat afatet ligjore për veprim janë të shkurtër, ndërsa në raste të tjera mos koordinimi i organeve shtetërore me ASH. Kjo veçanërisht ka të bëjë me atë kur ASH duhet të kërkoj pëlqim nga organi shtetëror për ndërmarrjen e veprimeve konform nenit 16 të Ligjit për Avokaturën e Shtetit.

Edhe më tutje konstatohet nevoja e instalimit të sistemit elektronik të ngjashëm me AKMIS i cili funksionon nëpër gjykata dhe në këtë mënyrë do të ekzistonte statistikë e detajuar përmes këqyrjes së shpejtë dhe transparente në çdo fazë në të cilën janë lëndët me ç'rast do të ekzistonte edhe rrjetëzimi i avokaturave të tjera midis tyre, si dhe me ASH për juridiksionin e Shkupit. Në këtë mënyrë avokaturat e shtetit do të kenë këqyrje në lëndët të cilat i përfaqësojnë ata, si dhe në lëndët të cilat me prokurë të përgjithshme përfaqësohen nga organet shtetërore.

Në përputhje me ingerencat e pëtcaktuara në Ligjin për Avokaturën e Shtetit në nenin 6 paragrafin 2 parashikohet mundësia ASHRMV t'i delegoj kompetencat sa i përket përfaqësimit personave të punësuar në organet shtetërore. Sipas informatave të pranuara nga ASHRMV për juridiksionin e Shkupit, me prokurë të përgjithshme në mënyrë të pavarur përfaqësohet Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Ministria e Mbrojtjes (MO), Ministria e Drejtësisë - INK Idrizovë, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Doganave. ASHRMV i monitoron procedurat, meqë të gjitha aktet nga gjykata deri te organet e lartpërmendura dërgohen përmes ASHRMV e cila njëkohësisht jep mendim për deponimin e mjeteve juridike.

3 Në seksionin për konteste tregtare nga gjithsej 30 lëndë, 10 lëndë akoma janë në punë, 1 lëndë është vazhdim i ndërprerjes së procedurës, 1 lëndë është shfuqizuar dhe lëndët e tjera kanë përfunduar. Në seksionin për falimentim dhe likuidim është evidentuar 1 lëndë e cila akoma është në punë.

4 Shih: Procesverbali i mbledhjes së 150 të Qeverisë së RMV https://vlada.mk/sednica/150

Përfaqësimi i organeve shtetërore me prokurë të përgjithshme nga ASHRMV	Periudha 1.5.2019-30.10.2019
Ministria e Punëve të Brendshme	814 lëndë
Ministria e Mbrojtjes	119 lëndë
INK Idrizovë	123 lëndë
Drejtoria e Doganave	4 lëndë

Në përputhje me të dhënat e dërguara nga ASHRMV për juridiksionin e Shkupit, numri më i madh i lëndëve të cilat janë ngritur në Gjykatën Themelore Civile Shkup, për periudhën kohore nga 1.5.2019 deri më 30.10.2019 kanë të bëjnë me konteste pune. Kundër Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit dhe Korrupsionit të Organizuar janë parashtruar 6 padi nga marrëdhënia e punës; kundër Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave janë parashtruar 58 padi për kompensime nga marrëdhënia e punës; kundër Gjykatës Themelore Kumanovë 6 padi; kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme 8 padi; kundër Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative 3 padi; kundër Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari 2 padi; kundër Agjencisë për Administratë 2 padi; kundër Gjykatës Administrative 3 padi; kundër Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor 11 padi; kundër Agjencisë për Zbulim 2 padi; kundër Ministrisë së Financave – Drejtorisë së të Ardhurave Publike 3 padi; kundër PTHP Shkup 5 padi; kundër Inspektoratit Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor 4 padi dhe kundër Agjencisë së Kadastrës së Patundshmërive 3 padi. Lidhur me Gjykatën Supreme të RMV; Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit; Kuvendin e RMV; Gjykatën e Apelit Shkup; Gjykatën Themelore Penale Shkup; PPRMV; Ministrinë e Financave; Agjencinë për Menaxhimin me Pronën e Sekuestruar; Agjencinë për të Rinj dhe Sport; Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve; Gjykatën Kushtetuese; Agjencinë për Nëpunës Shtetëror; Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrinë e Kulturës është parashtruar nga 1 padi.

Sa u përket lëndëve që kanë të bëjnë me kompensime nga marrëdhënia e punës dhe shtojca në paga, mund të mendohet që të përdoret instituti ujdi jashtëgjyqësore, përkatësisht në lëndët tek të cilat ekzistojnë prova evidente të cilat në procedurë eventuale gjyqësore do ta mbështesnin kërkesëpadinë e paditësit, të zgjidhen me ujdi midis organeve kompetente shtetërore dhe personit fizik të punësuar në atë organ. Në këtë mënyrë, në masë të konsiderueshme do të zvogëlohen shpenzimet të cilat paguhen nga Buxheti i RMV për përfaqësimin e prokuristëve të palëve, por edhe shpenzimet të cilat në bazë të taksave gjyqësore dhe ekspertizave u paguhen palëve të cilat kanë pasur sukses në kontestin.

Sipas të dhënave të pranuara nga avokaturat e tjera të shtetit për periudhën kohore 1.5.2019 - 30.10.2019, zhvillohen konteste pune kundër organeve të shtetit si vijon:

> ASHRMV për juridiksionin e Manastirit – 27 lëndë kundër MPB, 1 lëndë kundër MBPEU, 1 lëndë kundër DAP, 3 lëndë kundër Gjykatës së Apelit Manastir, 4 lëndë kundër Gjykatës Themelore Prilep, 1 lëndë kundër Qendrës të Shëndetit Publik, 1 lëndë kundër KSHZ-RMV, 1 lëndë kundër PP Manastir, 1 lëndë kundër Burgut Manastir dhe 2 lëndë kundër Ministrisë së Drejtësisë;

> ASHRMV për juridiksionin e Strugës – nuk ka procedura të ngritura kundër organeve shtetërore nga ana e nëpunësve të punësuar shtetërorë;

> ASHRMV për juridiksionin e Gostivar – nuk ka procedura të ngritura kundër organeve shtetërore nga ana e nëpunësve të punësuar shtetërorë;

> ASHRMV për juridiksionin e Kumanovës – 1 lëndë kundër Gjykatës Themelore Civile Shkup, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave 6 lëndë, Burgu Kumanovë me repartin e hapur në Kriva Pallankë fsh. Kshanje 12 lëndë;

> ASHRMV për juridiksionin e Tetovës – 3 lëndë kundër Ministrisë së Mbrojtjes, 1 lëndë kundër MPB dhe 1 lëndë kundër Ministrisë së Financave - DAP;

- ASHRMV për juridiksionin e Ohrit – nuk ka procedura të ngritura kundër organeve shtetërore nga ana e nëpunësve të punësuar shtetërorë;
- ASHRMV për juridiksionin e Strumicës – 34 lëndë kundër MPB, 24 lëndë kundër MBPEU, 8 lëndë kundër Gjykatës Themelore Strumicë, 1 lëndë kundër Gjykatës Themelore Radovish, 1 lëndë kundër INK Burgu Strumicë, 1 lëndë kundër DAP dhe një lëndë kundër PP Strumicë;
- ASHRMV për juridiksionin e Gjevgjelisë– 2 lëndë kundër MPB dhe 1 lëndë kundër Ministrisë së Financave - DAP.
- ASHRMV për juridiksionin e Kërçovës – 93 lëndë kundër Ministrisë së Mbrojtjes,[5] 7 lëndë kundër MPB dhe 2 lëndë kundër MBPEU;
- ASHRMV për juridiksionin e Prilepit – 6 lëndë pa e specifikuar kundër cilave organe shtetërore janë parashtruar padi;
- ASHRMV për juridiksionin e Koçanit – 56 lëndë kundër MPB, 11 lëndë kundër Gjykatës Themelore Koçan, Vinicë, Berovë dhe Dellçevë dhe 18 lëndë kundër MBPEU;
- ASHRMV për juridiksionin e Kavadarit –2 lëndë kundër PP të RMV;
- ASHRMV për juridiksionin e Shtipit– 558 lëndë kundër MPB, 175 lëndë kundër Ministrisë së Mbrojtjes, 9 lëndë kundër të paditurit INK Shtip, 1 lëndë kundër Gjykatës Themelore Shtip, 5 lëndë kundër Gjykatës Themelore Sveti Nikole, 2 lëndë kundër Gjykatës Themelore Radovish, 1 lëndë kundër Gjykatës Themelore Strumicë, 2 lëndë kundër Gjykatës së Apelit Shtip, 4 lëndë kundër MBPEU dhe 1 lëndë kundër Ministrisë së Drejtësisë.
- ASHRMV për juridiksionin e Velesit- nuk ka procedura të ngritura kundër organeve shtetërore nga ana e nëpunësve të punësuar shtetërorë.

5 Në Ministrinë e Mbrojtjes kemi konteste specifike ku kërkohet kompensim – shtesë për stërvitjen specifike ushtarake, kompensim në para për pjesëmarrje në misione paqeruajtëse jashtë vendit, kompensim në para për pushimin e shfrytëzuar vjetor dhe ngjashëm.

Monitorimi i procedurave gjyqësore në të cilat Avokatura e Shtetit e RMV paraqitet si përfaqësuese ligjore

Në periudhën kohore korrik-dhjetor të vitit 2019 Instituti për të Drejtat e Njeriut monitoroi më shumë se 70 lëndë nga të cilat për monitorim të mëtutjeshëm u seleksionuan 30 lëndë para Gjykatës Themelore Civile Shkup në të cilat si përfaqësues ligjor paraqitet Avokatura Shtetërore. Me fjalë të tjera, objekt i analizës dhe monitorimit ishin procedurat në baza të ndryshme edhe atë: 15 lëndë kanë të bëjnë me konteste pronësore si dhe konteste për kompensimin e dëmit për shkak të paraburgimit të pabazuar, anulimin e kontratës dhe ngjashëm, 2 lëndë kanë të bëjnë me falimentim, 2 lëndë kanë të bëjnë me procedura sipas urdhërpagesës në konteste ekonomike, 1 lëndë me vlerë të vogël, 1 lëndë ekonomike dhe 9 lëndë nga marrëdhënia e punës pjesa më e madhe e të cilave kanë të bëjnë me kompensime nga marrëdhënia e punës dhe një pjesë e vogël me anulimin e vendimit për përjashtim nga marrëdhënia e punës.

Në këtë periudhë gjashtëmujore, theks i veçantë ishte vendosur mbi çështjet kontestimore/pronësore në të cilat vjen në shprehje roli i ASHRMV në mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe interesave të RMV dhe organeve të shtetit. Për këtë shkak, këto lëndë në shumicën e rasteve në Gjykatën Themelore Civile përfaqësohen nga avokatët e shtetit të zgjedhur për juridiksionin e Qytetit të Shkupit. Së këtejmi, IDNJ i monitoroi lëndët për përcaktimin e të drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme, sende për kompensim të dëmit për shkak të paraburgimit të pabazuar të cilat në mënyrë të veçantë nxitën interesim tek publiku më i gjerë, meqë bëhet fjalë për lëndë paraburgimet e të cilave u aktualizuan në të kaluarën, ndërsa pasojat janë akoma të pranishme përmes ngritjes së procedurave për kompensim të dëmit. Pastaj, objekt i monitorimit ishte edhe lënda për anulimin e kontratës të cilën e ka lidhur RMV si dhe lënda në bazë të borxhit.

Nga monitorimi i lëndëve të lartpërmendura mund të konstatohet se bashkëpunimi[6] i organeve shtetërore me ASHRMV është i vazhdueshëm, edhe pse në raste të caktuara paraqiten vështirësi të cilat janë rezultat i afateve të shkurtra për veprim për çka parapriu shkëmbim i korrespondencës dhe konsultave rrjedhëse për ndërmarrjen e veprimeve juridike.

Вонсудски спогодби за спорови од имотно-правен карактер

Nga përgjigjet e pranuara prej avokaturave të shtetit për juridiksionin e Shkupit; Manastirit; Strugës; Gostivarit; Kumanovës; Tetovës; Ohrit; Shtipit; Velesit; Strumicës; Gjevgjelisë, Kërçovës; Prilepit, Koçanit dhe Kavadarit për periudhën kohore nga data 1.5.2019 deri më datë 30.10.2019, **nuk është lidhur asnjë ujdi jashtëgjyqësore**. Edhe krahas kompleksitetit të këtyre kontesteve, megjithatë në lëndët në të cilat ekzistojnë prova evidente dhe të bazuara në fakte, mund të mendohet për lidhjen e ujdisë jashtëgjyqësore për shkak të ekonomizimit të procedurës në mënyrë që të shmangen shpenzime plotësuese të cilat do ta rëndonin Buxhetin e shtetit duke arritur shuma të konsiderueshme në emër të borxhit kryesor dhe kamatave..

6 Bashkëpunimi i organeve të administratës shtetërore me Avokaturën e Shtetit është parashikuar në nenin 14 të Ligjit për Avokaturën e Shtetit.

Mbrojtja e të drejtave pronësore dhe interesave të RMV

Avokatura e Shtetit merr pjesë në procedurat e tjetërsimit të tokës ndërtimore të ndërtuar dhe të pa ndërtuar përmes dhënies së mendimit pozitiv ose negativ, privatizimit të tokës, tjetërsimit të paluajtshmërive në pronësi të shtetit, shkëmbimit të tokës bujqësore, si dhe përmes vazhdimit të kontratave për qiradhënie të tokës bujqësore.

Pjesëmarrja aktive e ASHRMV në procedurën e tjetërsimit të tokës ndërtimore të pa ndërtuar në pronësi të shtetit bazohet në nenin 56 të Ligjit për noteri. Me fjalë të tjera, ligji, sa i përket procedurës së tjetërsimit të tokës ndërtimore të pa ndërtuar, në pronësi të shtetit, thekson se noteri e ka për detyrë të shqyrtoj se a është siguruar mendim nga Avokati i Shtetit, nëse bëhet fjalë për verifikimin e dokumentit në bazë të të cilit bëhet bartja e të drejtës së pronësisë, përkatësisht shkëmbimi i paluajtshmërive, me ç'rast si një nga palët kontraktuese paraqitet shteti, ndërsa pala tjetër është person fizik ose juridik. Nëse për dokumentin privat nuk është siguruar mendim, noteri për këtë e njofton Avokatin e Shtetit dhe e shtyn verifikimin e dokumentit derisa të sigurohet mendimi, më së voni deri në 30 ditë.

Në përputhje me të dhënat e pranuara nga Avokatët e Shtetit për juridiksionin e Shkupit; Manastirit; Strugës; Gostivarit; Kumanovës; Tetovës; Ohrit; Shtipit; Velesit; Strumicës; Gjevgjelisë, Kërçovës; Prilepit, Koçanit dhe Kavadarit për periudhën kohore nga data 1.5.2019 deri në datën 30.10.2019, janë dhënë mendimet si vijon:

ASH sipas juridiksionit	Mendime pozitive	Mendime negative	Shkaqe të tjera
Shkup	83	5	29 (sugjerime për sqarime plotësuese të fakteve të caktuara)
Strugë dhe Dibër	7	/	3 kërkesa akoma janë në punë
Gostivar	50	/	/
Kumanovë	13	/	/
Tetovë	24	2	/
Ohër	12	/	/
Strumicë	17	/	14 (sugjerime për mangësi)
Manastir	7	/	1 (sugjerim për mangësi)
Gjevgjeli	14	/	/
Kërçovë	14	/	5 kërkesa akoma janë në punë
Prilep	50	/	ASH për juridiksionin e Prilepit nuk ka theksuar sa prej këtyre mendimeve janë pozitive/negative
Koçan	48	/	/
Kavadar	25	1	4 sugjerime
Shtip	4	1	3 sugjerime
Велес, Неготино и Д. Капија	50	/	/

Në lidhje me numrin e kontratave të lidhura për tjetërsimin e tokës ndërtimore (për qiradhënie në afat të shkurtër dhe të gjatë) për periudhën kohore nga data 1.5.2019 deri më datë 30.10.2019, për juridiksionin e Avokaturës së Shtetit – Shkup është evidentuar vetëm një Kontratë për tjetërsimin e tokës ndërtimore pa ankand publik për qiradhënie në afat të shkurtër ose në afat të gjatë dhe për të njëjtën është dhënë mendim pozitiv.

Nga Avokaturat e tjera të shtetit, ASH për juridiksionin e Tetovës ka lidhur 3 kontrata për qiradhënie në afat të gjatë të tokës ndërtimore për të cilat janë dhënë tre mendime pozitive, ASH për juridiksionin e Shtipit ka formuar 4 lëndë sipas kërkesës për mendim për draft-kontratë për tjetërsimin e tokës ndërtimore në pronësi të shtetit me marrëveshje të drejtpërdrejt, prej të cilave për një lëndë është dhënë mendim negativ ndërsa për 3 lëndët e tjera është dhënë mendim me sugjerim. ASH për juridiksionin e Shtipit ka lidhur 2 kontrata për qiradhënie me afat të gjatë të tokës ndërtimore. Sipas të dhënave të pranuara nga ASH për juridiksionin e Strugës, Gostivarit, Kumanovës, Strumicës, Manastirit, Ohrit, Kavadarit, Gjevgjelisë, Kërçovës, Prilepit dhe Koçanit nuk kanë lidhur kontrata të këtilla.

Në lidhje me rastet e veçanta të përgjegjësisë së dëmit për të cilat përgjigjet shteti (për dëm të shkaktuar nga ndonjë vepër e korrupsionit), në përputhje me përgjigjet e pranuara nga Avokaturat e shtetit për 15 (pesëmbëdhjetë) juridiksione në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk janë regjistruar lëndë të këtilla.

Denacionalizimi

Në përputhje me Ligjin për denacionalizim, përkatësisht nenin 14-a parashikohet se procedura e denacionalizimit është urgjente, me ç'rast organi i denacionalizimit e ka për detyrë kërkesat për denacionalizim t'i marrë në punë sipas radhës së pranimit, përveç nëse kompleksiteti i rastit ose rrethana të veçanta imponojnë që të veprohet ndryshe. Megjithatë, praktika vë në dukje se këto procedura zhvillohen disa vjet, fakt ky i cili u konstatua edhe në raportet paraprak të monitorimit të IDNJ.

Në përputhje me përgjigjen e pranuar nga Gjykata Administrative në bazë të kërkesës së parashtruar për qasje të lirë deri te informacionet lidhur me procedurat për denacionalizim përfundimisht me datë 30.11.2019 janë aktive edhe 1.229 lëndë, ndërsa janë zgjidhur 393 lëndë.

Sipas evidencës së Gjykatës së Lartë Administrative, në periudhën kohore nga data 1.5.2019 përfundimisht me datë 30.11.2019, janë pranuar gjithsej 218 lëndë nga fusha e denacionalizimit nga të cilat në periudhën e theksuar janë zgjidhur 265 lëndë.

Informacione të pranuara nga avokatura të shtetit për 15 (pesëmbëdhjetë) juridiksione lidhur me procedurat për denacionalizim:

Qytete	Konteste të ngritura administrative në periudhën kohore 1.5.2019-30.10.2019	Ankesa të parashtruara deri te Gjykata e Lartë Administrative për denacionalizim në periudhën kohore 1.5.2019-30.10.2019	Procedura për denacionalizim të cilat akoma janë në rrjedhë e sipër në periudhën kohore 1.5.2019-30.10.2019
Shkup	15	1	7 lëndë (nga të cilat për 2 janë ngritur konteste administrative)
Manastir	3	/	Nuk ka lëndë të reja në periudhën e theksuar, ndërsa akoma janë në punë 1666 lëndë
Strugë	0	1	Nuk ka lëndë të reja në periudhën e theksuar, ndërsa akoma janë në punë 134 lëndë
Gostivar	6	11	Nuk ka informacione të dërguara
Kumanovë	15	0	89 lëndë
Tetovë	1	0	421 lëndë
Ohër	0	0	135 lëndë
Shtip	1	0	150 lëndë
Veles	0	/	Nuk ka lëndë
Strumicë	0	0	129 lëndë
Gjevgjeli	2	0	49 lëndë
Kërçovë	/	1	263 lëndë
Prilep	5	/	71 lëndë
Koçan	2	0	500 lëndë
Kavadar	2	2	35 lëndë

Ekspropriimi i tokës

Në procedurat e ekspropriimit, ish-pronarët e tokave më së shpeshti parashtrojnë padi meqë janë të mendimit se u ofrohen çmime më të ulëta nga vlera e tregut të tokave. Në këtë konotacion Kushtetuta e RMV përcakton *"Në rast të ekspropriimit të pronësisë, ose në rast të kufizimit të pronësisë, garantohet kompensim i drejtë i cili nuk mund të jetë më i ulët nga vlera e tregut"*. Nga ana tjetër, Ligji për ekspropriim e rregullon heqjen dhe kufizimin e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave pronësore mbi paluajtshmërinë me qëllim të realizimit të interesit publik të përcaktuar me ligj, për shkak të ndërtimit të objekteve dhe realizimit të punëve tjera, përcaktimit të interesit publik, procedurës së ekspropriimit dhe procedurës së përcaktimit të kompensimit sipas tregut.

Në përputhje me të dhënat e pranuara nga Gjykata Administrative, numri i lëndëve aktive në bazë të ekspropriimit përfundimisht me datë 30.11.2019 është 27 lëndë, ndërsa numri i lëndëve të zgjidhura në periudhën kohore nga data 1.5.2019-30.11.2019 deri më datë është 92 lëndë.

Në Gjykatën e Lartë Administrative në periudhën kohore nga data 1.5.2019, përfundimisht me datën 30.11.2019 janë pranuar gjithsej 30 lëndë nga fusha e ekspropriimit nga të cilat në periudhën e theksuar kohore janë zgjidhur 26 lëndë.

Procedurat e athezionit

Në procedurat e athezionit, avokaturat e shtetit duke e përfaqësuar RMV dhe organet e saj, parashtrojnë kërkesa pronësore-juridike të adresuara deri te të akuzuarit në procedura penale. Kjo pjesëmarrje është si rezultat i procedurave tanimë të ngritura hetuese dhe penale nga ana e PPRMV procedura këto që kanë të bëjnë me lëndë në lidhje me shpërdorimin e pozitës zyrtare dhe autorizimit, evazionin tatimor, veprime korruptive dhe ngjashëm. Sipas përgjigjeve të pranuara për periudhën kohore nga data 1.5.2019 – deri më datë 30.10.2019 nga Avokaturat e shtetit për juridiksionin e Shkupit zhvillohen 22 procedura të athezionit: për Velesin 3; për Gostivarin 4; për Tetovën 1; për Kumanovën 4; për Ohrin 1; për Shtipin 5; për Strumicën 9; për Kërçovën 2; për Prilepin 10. Për juridiksionet e Manastirit, Strugës, Koçanit, Kavadarit dhe Gjevgjelisë nuk janë ngritur procedura të athezionit.

Shuma e paguar/arkëtuar nga/në Buxheti i RMV në lidhje me procedurat gjyqësore

Në përputhje me përgjigjen e pranuar nga ASHRMV për juridiksionin e Shkupit, në pyetjen cila shumë është paguar/arkëtuar nga/në Buxheti i RMV u theksua se nuk kanë në dispozicion informata të kësaj natyre meqë mjetet paguhen përmes Ministrisë së Financave, ndërsa shpenzimet e përfaqësimit të cilat i janë specifikuar ASHRMV arkëtohen nga Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe të njëjtat paraqesin të ardhura buxhetore.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, ekziston nevoja edhe avokaturat e shtetit të mbajnë evidencë për shumat e paguara dhe/ose arkëtuara nga/në Buxheti i RMV, me ç'rast krahas institucioneve të tjera relevante siç është Ministria e Financave dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike ashtu edhe ASHRMV do të kishin këqyrje në lëndët deri në ekzekutimin e tyre. Kjo evidencë është veçanërisht e rëndësishme për avokaturat e shtetit në mënyrë që të kenë pasqyrë edhe sa i përket suksesit të çdo lënde të regjistruar (në procedurë gjyqësore dhe/ose administrative), pavarësisht nëse veprojnë si përfaqësues sipas ligjit ose me prokurë të përgjithshme i autorizojnë organet shtetërore të përfaqësohen vet.

Në vazhdim është tabela konform informatave të pranuara nga Avokaturat e tjera të shtetit, për periudhën kohore nga data 1.5.2019 deri më datë 30.10.2019:

ASHRMV	Shuma e paguar nga Buxheti i RMV në emër të shpenzimeve për përfaqësim	Shuma e paguar nga Buxheti i RMV palëve të cilat kanë pasur sukses në kontestin	Shuma e arkëtuar në dobi të Buxhetit të RMV nga palët të cilat nuk kanë pasur sukses në kontestin
Manastiri	1.047.114,00 denarë (kompensim i dëmit)		694.887,00 denarë
Gostivari	51.614,00 denarë		/
Kumanova	Janë paguar 1.857.851,00 denarë në bazë të urdhrave për ekzekutim në lëndë penale. Për lëndët e tjera nuk kanë informacione.		/
Ohri	Nuk ka lëndë të formuara		944.127,00 denarë
Shtipi	Nuk ka lëndë të formuara		507.118,00 denarë, në procedurë ekzekutive 219.700,00 denarë
Gjevgjelia	585.059,00 denarë		78.920,00 denarë
Kërçova	529.114,00 denarë		192.870,00 denarë dhe
Kavadari	/		46.800,00 denarë

*Avokaturat e Shtetit për juridiksionet e Velesit, Strugës, Tetovës, Strumicës, Prilepit dhe Koçanit deklaruan se nuk i posedojnë informacionet e nevojshme meqë arkëtimi i shpenzimeve bëhet përmes Ministrisë së Financave – Drejtoritë së të Ardhurave Publike.



SCOOP CIJ-MACEDONIA Supporting Investigative Journalism... Center for Investigative Journalism SCOOP Macedonia

Институт за човекови права

MEDIUM